

BULETIN INFORMATIV

Nëntor 2024

Qendra
"Aleanca Gjinore për Zhvillim"

Konferencë Kombëtare

"Fuqizim, Rikuperim,
Riintegrim: Fuqizimi i
Shërbimeve për
Viktimat e Dhunës
me Bazë Gjinore"

Tiranë, 27 Nëntor 2024

Konferenca Kombëtare me temë "Fuqizim, Rikuperim, Riintegrim: Fuqizimi i Shërbimeve për Viktimat e Dhunës me Bazë Gjinore", një iniciativë që synon të avancojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegritimit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.

Organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim në bashkëpunim me Rrjetin Shqiptar për Fuqizimin e Grave, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).



Partneritet i Ri



Dhuna me bazë gjinore mbetet një problem i rëndësishëm në Shqipëri, ku të mbijetuarat/it përballen me pengesa të mëdha në procesin e rikuperimit dhe riintegrit në shoqëri. Nevoja për shërbime gjithëpërfshirëse dhe të specializuara për mbijetuarat/it është më urgjente se kurrë.

Ky aktivitet i zhvilluar kishte për qëllim të trajtonte këtë nevojë, duke mbledhur aktorë kyç nga sektorë të ndryshëm për të diskutuar, ndarë përvoja dhe zhvilluar strategji për përmirësimin e shërbimeve për të mbijetuarit e dhunës. Së bashku, u eksploruan politika, u ndanë praktika të mira dhe u promovuan zgjidhje inovative për të siguruar që të mbijetuarit e dhunës të marrin mbështetje të gjithanshme, të dhembshur dhe efektive, për t'i ndihmuar ata të rindërtojnë jetën e tyre.

Objektivat

- Thellimi i kuptimit të standardeve ndërkombëtare dhe politikave kombëtare që formësojnë shërbimet për të mbijetuarat e dhunës, me fokus në përafrimin e praktikave të Shqipërisë me standardet dhe standardet ndërkombëtare.
- Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorëve kyç—shëndetësor, ekonomik, social, drejtësi, dhe të tjerë—për të krijuar sisteme të integruara dhe të përqendruara të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore për rehabilitim dhe riintegrim.
- Zhvillimi i një vizioni kolektiv për të ardhmen e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, duke siguruar qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë.
- Lehtësimi i mundësive për rrjetëzim, për të inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet organizatave, aktorëve dhe të mbijetuarve në avancimin e përpjekjeve kolektive për përmirësimin e shërbimeve.





Znj. Mirela Arqimandriti
Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Znj. Mirela Arqimandriti, Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, hapi konferencën duke theksuar rëndësinë e adresimit të dhunës me bazë gjinore dhe theksoi nevojën për shërbime të specializuara dhe të integruara për viktimat e dhunës. Ajo theksoi se është thelbësore që të gjithë aktorët, përfshirë sektorin publik, shoqërinë civile dhe institucionet ndërkombëtare, duhet të punojnë së bashku për të krijuar një sistem të qëndrueshëm që ofron mbështetje të gjithanshme dhe efektive për viktimat e dhunës.

Në këtë konferencë, u diskutua për përmirësimin e shërbimeve për viktimat e dhunës, duke u fokusuar veçanërisht në shërbimet e rehabilitimit që përfshijnë mbështetje psikologjike, ndihmë ligjore dhe mbështetje ekonomike. Znj. Arqimandriti nënvizoi faktin që shumë viktima përballen me barrierat sociale dhe ekonomike që i detyrojnë të mbeten në marrëdhënie abuzive ose të kenë vështirësi për të rifilluar jetën e tyre pas përjetimit të dhunës. Ajo gjithashtu theksoi nevojën për një qasje të integruar që adreson nevojat e viktimave në mënyrë të gjithanshme, duke ofruar mbështetje përmes shërbimeve sociale, rehabilituese dhe ekonomike.

Një tjetër çështje e rëndësishme që u diskutua ishte mungesa e mbështetjes ligjore dhe shërbimeve të cilat janë të nevojshme për të siguruar që të gjitha viktimat të kenë mundësinë të denoncojnë dhunën dhe të marrin mbrojtje ligjore. Znj. Arqimandriti theksoi gjithashtu rëndësinë e një mbështetjeje të vazhdueshme, duke patur parasysh se ndonëse ka pasur përmirësime të dukshme në legjislacion, aplikimi dhe zbatimi i ligjit mbetet ende një sfidë. Shumë viktima ndihen të pasigurta për të raportuar dhunën për shkak të frikës nga represioni dhe mungesa e mbrojtjes efektive.

Në konferencë u diskutua gjithashtu për rëndësinë e edukimit dhe ndërgjegjësimin publik lidhur me dhunën me bazë gjinore, sidomos në zonat rurale, ku informacioni është më i kufizuar dhe ku shpesh dhuna normalizohet. Znj. Arqimandriti theksoi se është e domosdoshme që të gjitha nivelet e shoqërisë, përfshirë institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet ndërkombëtare të bashkëpunojnë për të krijuar një sistem më të fortë dhe më të qëndrueshëm që mund të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Ky aktivitet përfshiu pjesëmarrjen e profesionistëve, avokatëve të drejtave të njeriut, përfaqësuesve të institucioneve dhe shoqërisë civile, të cilët ndanë përvojat dhe praktikat më të mira për të adresuar dhunën me bazë gjinore dhe për të kontribuar në ndihmën ndaj të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore. Duke përfunduar, znj. Arqimandriti ftoi të gjithë pjesëmarrësit që të vazhdojnë të punojnë për forcimin e shërbimeve ekzistuese dhe për të krijuar modele të reja të qëndrueshme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e mbështetjes dhe integritit të viktimave të dhunës në shoqëri.



Znj. Etilda Gjonaj

Deputete në Kuvendin e Shqipërisë,
Raportuese e Përgjithshme për
dhunën ndaj grave në Këshillin e Evropës

Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës ndaj Grave, Etilda Gjonaj, Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, theksoi rëndësinë e vazhdimit të angazhimit për të luftuar dhunën gjatë gjithë vitit, duke i shfrytëzuar këto ditë për të sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar shoqërinë. Ajo theksoi se, megjithëse aktivitetet për dhunën ndaj grave janë të përqendruara në këtë periudhë, puna për të ndihmuar viktimat dhe për të parandaluar dhunën duhet të jetë një angazhim i përhershëm.

Në fjalën e saj, znj. Gjonaj vuri në dukje disa shifra shqetësuese që pasqyrojnë situatën e dhunës ndaj grave në Shqipëri dhe Evropë. Ajo bëri të ditur se një në tre gra është viktimë e dhunës në të gjitha format, ndërsa 18% e grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe seksuale kanë kaluar gjithashtu dhunë në familje. Po ashtu, një në tetë gra ka përjetuar dhunë seksuale, përfshirë përdhunimin, duke theksuar seriozitetin e situatës dhe nevojën për ndërhyrje të shpejtë.

Duke u fokusuar në një problem gjithnjë në rritje, dhunën online, znj. Gjonaj theksoi se 41.1% e vajzave dhe grave kanë raportuar përvojat e ngacmimeve dhe përndjekjes online, një fenomen që po merr përmasa shqetësuese. Për deputeten Gjonaj, këto statistika janë një pasqyrë e realitetit të dhunës ndaj grave dhe duhet të na nxisin të veprojmë sa më shpejt dhe të ndërtojmë një shoqëri më të sigurt për gratë dhe vajzat. Znj. Gjonaj gjithashtu ndau përvojën e saj nga vizitat në disa streha në Tiranë dhe Kamëz, ku pa nga afër trajtimin e grave viktime të dhunës. Ajo theksoi se, megjithëse shërbimet e nevojshme janë të disponueshme, sfida më e madhe mbetet riintegrimi i këtyre grave në shoqëri, veçanërisht për ato që vijnë nga qytete të vogla dhe kanë kaluar shumë barriera, si ndarja nga familja e origjinës dhe humbja e të drejtave të tjera.

Për më tepër, znj. Gjonaj vuri në dukje se edukimi është çelësi për të parandaluar dhunën dhe për të krijuar një shoqëri më të ndjeshme ndaj këtyre çështjeve. Ajo theksoi se është e nevojshme që vajzat dhe gratë të kuptojnë se çfarë përbën dhunë dhe të denoncojnë çdo rast abuziv. Një tjetër pikë e rëndësishme në fjalimin e saj ishte mbështetja për shoqërinë civile dhe organizatat që luftojnë kundër dhunës ndaj grave. Znj. Gjonaj theksoi se këto organizata përballen me vështirësi nëse nuk kanë mbështetje buxhetore të qëndrueshme dhe kërkoi që donatorët dhe agjencitë ndërkombëtare të vazhdojnë të mbështesin iniciativat që mundësojnë një punë më të fortë dhe më të qëndrueshme në këtë drejtim.

Për të përmbyllur, Etilda Gjonaj theksoi se është i domosdoshëm një kuadër ligjor i dedikuar për riintegrimin e viktimave të dhunës dhe mbështetja krijimin e një kodi specifik që do të ndihmonte në trajtimin e viktimave dhe në parandalimin e dhunës, duke përfshirë aspektet sociale, ligjore dhe financiare. Ajo gjithashtu shprehu besimin se, duke përfshirë këto elemente në politikat dhe strategjitë kombëtare, Shqipëria mund të bëjë përparim të qëndrueshëm në luftën kundër dhunës ndaj grave.

Në fjalën e saj, Znj. Denada Seferi theksoi rëndësinë e shërbimeve cilësore të integruara për viktimat e dhunës dhe të mbijetuarat, duke falenderuar shoqërinë civile për kontributin e tyre 20-vjeçar në këtë fushë. Ajo vuri në dukje që ky event sjell së bashku aktorë të ndryshëm, nga politikbërës dhe aktivistë, deri tek partnerët ndërkombëtarë, për të ngritur çështje të caktuara në një nivel më të lartë të konsultimeve publike dhe për të diskutuar hallkat e dobëta të sistemit.



Znj. Denada Seferi
Zëvendësministre e Shëndetësisë
dhe Mbrojtjes Sociale

Znj. Seferi theksoi se politika aktuale për mbrojtjen e viktimave implementohet përmes mekanizmave të referimit në 61 bashki të vendit dhe nga strukturat lokale që mbështesin viktimat e dhunës dhe u ofrojnë mundësinë për të qenë pjesë e programeve të mbrojtjes sociale. Ajo gjithashtu theksoi rëndësinë e programave të përfshirjes sociale, që përfshijnë sektorë të tjerë si punësimi, edukimi, rehabilitimi dhe shërbimet riintegruese.

Në Shqipëri aktualisht janë 39 shërbime në nivel lokal që ofrojnë ndihmën e parë për viktimat e dhunës, duke përfshirë streza, shërbime komunitare dhe qendra multifunksionale. Rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave të dhunës është parë në një kuadër më holistik, duke filluar që nga momenti i identifikimit të dhunës, ngritjen e strukturave të posaçme në polici dhe vijimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e prekura nga dhuna.

Znj. Seferi theksoi gjithashtu se çdo hallkë e sistemit ka përgjegjësinë e saj dhe etika profesionale duhet të jetë në nivelin më të lartë, për të siguruar një trajtim me dinjitet për viktimat. Në këtë drejtim, ajo përmendi trajnimin e mbi 500 punonjësve, mbështetur nga agjencitë ndërkombëtare si UNDP dhe UN Women, për të përmirësuar sjelljen dhe etikën profesionale në ofrimin e shërbimeve.

Përsa i përket mekanizmave të shërbimeve, Qendra Liliun për viktimat e dhunës seksuale dhe dy qendra për viktimat e dhunës seksuale të fëmijëve në Fier dhe Shkodër janë shembuj të shërbimeve të specializuara. Fondi Social ka ngritur më shumë se 73 shërbime të integruara sociosëndetësore, që ofrojnë mbështetje për 33,000 përfitues, shumica e të cilëve janë viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare. Po ashtu, 9 shërbime janë të dedikuara për trajtimin e viktimave të dhunës dhe janë streha në bashki të ndryshme.

Znj. Seferi theksoi se sistemi i shërbimeve duhet të funksionojë në mënyrë të harmonizuar dhe është duke u riparuar për të siguruar që ato të jenë në përputhje me standartet europiane. Kjo është e mundur vetëm përmes përmirësimit të mekanizmave të referimit dhe të monitorimit të çdo rasti. Ajo kërkoi nga shoqëria civile dhe nga mekanizmat e referimit që të monitorojnë çdo rast deri në fund dhe të sigurojnë që viktimat të mos kthehen në situatën e dhunës.

Në përfundim, Znj. Seferi theksoi se është thelbësore që të flasim jo vetëm për shërbime, por për shpëtimin e jetëve, forcimin e familjeve, dhe shpëtimin e fëmijëve që kanë përjetuar dhunë.

Prezantimi i Kontekstit dhe Diskutime mbi Politikat

Znj. Monika Zach, Ambasadorja e Austrisë në Shqipëri, vuri në dukje angazhimin e Austrisë në luftën kundër dhunës ndaj grave, duke theksuar se kjo është një prej prioriteteve më të rëndësishme të politikës ndërkombëtare të Austrisë. Ajo përmendi mbështetje të vazhdueshme për projekte globale dhe lokale që luftojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave, duke theksuar rolin e rëndësishëm të Konventës së Stambollit. Austria, përmes Agjencisë Austriake për Zhvillim, ka mbështetur shumë projekte dhe ka qenë një partner i besueshëm në përpjekjet për të parandaluar dhunën.



Znj. Monika Zach
Ambasadore e Austrisë
në Shqipëri

Ambasadorja përmendi se Austria ka mbështetur fushatën Orange the World, një iniciativë globale që ka si qëllim ndërgjegjësimin për dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe ka kontribuar gjithashtu në implementimin e projekteve që synojnë të mbështesin shoqërinë shqiptare në luftën kundër dhunës. Ajo vuri në dukje gjithashtu që Shqipëria është një vend prioritar për Austrinë që nga vitet '90, dhe ky angazhim ka vijuar nëpërmjet mbështetjes për shërbime mbrojtëse dhe projekte të orientuara për të përmirësuar legjislacionin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës.

Në aspektin global, Ambasadorja theksoi se dhuna ndaj grave është një problem që prek shumë shtete dhe që kërkon një bashkëpunim të fuqishëm ndërkombëtar për t'u adresuar. Ajo theksoi se përpjekjet ndërkombëtare dhe atyre të Austrisë janë të një rëndësie të veçantë për të zhvilluar politika që i japin fund dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe për të siguruar që viktimat të kenë mundësi për mbështetje, rehabilitim dhe riintegrim në shoqëri. Ajo vuri në dukje se Austria është mbështetëse e projekteve që synojnë të luftojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave nëpërmjet 41 projekteve të mbështetura në mbarë botën.

Një nga temat kryesore të fjalimit të znj. Zach ishte rëndësia e institucionalizimit të shërbimeve për viktimat e dhunës. Ajo vuri në dukje që Shqipëria ka bërë përparime të dukshme që nga ratifikimi i Konventës së Stambollit, duke krijuar një kornizë ligjore më të fortë dhe duke mbështetur zhvillimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat. Megjithatë, Austria dhe Shqipëria përballen me sfida të vazhdueshme për të hequr pengesat në sistemin e shërbimeve dhe për të siguruar financim të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve për viktimat në nivel lokal.

Znj. Zach theksoi gjithashtu se ende ka shumë për të bërë për të përmirësuar mbështetjen e viktimave të dhunës. Ajo theksoi nevojën për një bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë për të siguruar që shërbimet të jenë të aksesueshme dhe të përqendruara tek nevojat e viktimave. Ajo kërkoi që të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të mbështetur viktimat e dhunës dhe për të siguruar që ato të kenë mundësi për rehabilitim dhe riintegrim në shoqëri.

Në përfundim, Ambasadorja theksoi se Austria mbetet e angazhuar për të mbështetur Shqipërinë dhe për të kontribuar në arritjen e një shoqërie pa dhunë. Ajo shprehu mirënjohjen për përpjekjet e vazhdueshme të shoqërisë civile dhe përkushtimin e organizatave ndërkombëtare, duke nënvizuar se vetëm përmes bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët mund të arrijmë objektivat për një shoqëri më të sigurt për gratë dhe vajzat.



Znj. Fiona McCluney
Koordinatorë Rezidente e OKB-së
në Shqipëri

Znj. Fiona McCluney, Koordinatorë Rezidente e OKB-së në Shqipëri, theksoi rëndësinë e fushatës "Orange the World", duke veshur ngjyrën portokalli çdo ditë për të ndihmuar në ndërgjegjësimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Ajo theksoi se ky angazhim është një nga prioritetet globale të OKB-së, duke nënvizuar se dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është thjesht një problem që lidhet me ndërhyrje të izoluar, por kërkon një përpjekje të koordinuar dhe afatgjatë. Znj. McCluney vuri në dukje se është e rëndësishme që ne të qëndrojmë të angazhuar dhe të mbështesim veprime që e bëjnë ndryshimin të mundshëm.

Znj. McCluney shprehu mirënjohjen ndaj Qendrës "Aleanca Gjimore për Zhvillim" dhe Rrjetin Shqiptar për Fuqizimin e Grave, për përkushtimin e tyre në luftën kundër dhunës gjimore, ku edhe theksoi se kjo iniciativë rajonale është një mundësi për të diskutuar dhe përmirësuar mekanizmat e ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës në Shqipëri. Ajo përmendi që, si në shumë vende të tjera, përpjekjet për të ndihmuar viktimat kërkojnë një angazhim të përbashkët nga të gjitha palët, duke përfshirë OKB-në, agjencitë ndërkombëtare, shoqërinë civile, si dhe qeveritë lokale dhe qendrore.

Znj. McCluney gjithashtu ndau një përvojë personale lidhur me një ngjarje tragjike femicidi, e ndodhur në një shkollë në Mbretërinë e Bashkuar, ku një mësuese e shkollës u vra nga bashkëshorti i saj. Ky incident theksoi znj. McCluney tregon edhe një herë se dhuna ndaj grave është një problem i gjithanshëm dhe përfshin të gjitha shtresat e shoqërisë, pavarësisht mjedisit ku ndodhin. Ky ishte një shembull i dhunës ekstreme që tregon nevojën për të vepruar.

Në vijim znj. McCluney theksoi përpjekjet e OKB-së për të siguruar që ligjet dhe politikat e implementuara për të luftuar dhunën gjimore të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pjesë e këtij angazhimi është programi që UN Women, UNDP dhe UNFPA po zbatojnë për të luftuar dhunën ndaj grave, i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe e Mbretërisë së Bashkuar.

Ky program përfshin dy aspekte kryesore:

1. Krijimin e një kornize ligjore për të përmirësuar legjislacionin dhe,
2. Zhvillimin e një mekanizmi të koordinuar të përgjigjes në nivelin lokal, ku komunitetet dhe shërbimet sociale mund të ndërveprojnë dhe të trajtojnë viktimat më efektivisht.

Në përmbyllje, Znj. McCluney theksoi se ne duhet të vazhdojmë të punojmë së bashku për të siguruar një shoqëri më të drejtë dhe më të sigurtë për gratë dhe vajzat, dhe të qëndrojmë të angazhuar në përpjekjet tona për të mposhtur dhunën gjimore në të gjitha nivelet.

Ceremonia e nënshkrimit të grantit: Marrëveshja e Grantit për projektin rajonal “Institucionalizimi i Shërbimeve Cilësore të Rehabilitimit dhe Riintegritimit për Viktimat e Dhunës II”



Marrëveshja e Grantit për fazën e dytë të projektit **“Institucionalizimi i Shërbimeve Cilësore të Rehabilitimit dhe Riintegritimit për Viktimat e Dhunës”** u nënshkrua gjatë konferencës nga znj. Mirela Arqimandriti (GADC) dhe z. David Muckenhuber, Shef i Zyrës Rajonale të Koordinimit për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Agjencia Austriake për Zhvillim.

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” është organizata që do të drejtojë këtë projekt rajonal.

Përmbledhje e Projektit

Ky projekt rrit aksesin në shërbime cilësore për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore (DhBGj) në Ballkanin Perëndimor, duke forcuar kapacitetet profesionale, avokuar për ndryshime sistematike dhe fuqizuar shoqërinë civile. Nëpërmjet programeve të trajnimit, linjave ndihmëse SOS, ndihmës juridike dhe mbështetjes psikologjike, sigurohet që të mbijetuarat të përfitojnë mbështetje gjithëpërfshirëse. Iniciativat e avokimit synojnë promovimin e autonomisë së të mbijetuarave, institucionalizimin e shërbimeve të rehabilitimit dhe advokimit për ndarje më të drejtë të buxhetit shtetëror dhe zbatim efektiv të politikave. Përveç kësaj, aktivitetet e rrjetëzimit, monitorimit dhe shkëmbimit të njohurive fuqizojnë organizatat e shoqërisë civile për të bashkëpunuar me efektivitet dhe për të nxitur ndryshime të qëndrueshme. Këto përpjekje janë në përputhje me Konventën e Stambollit, duke përmirësuar sistemet mbështetëse, fuqizimin e të mbijetuarave dhe duke kontribuar në një ndikim afatgjatë në rajon.

Ndikimi dhe rezultatet e pritshme

Impakti: Arritja e aksesit të plotë në shërbime cilësore për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore (DhBGj) në Ballkanin Perëndimor (BP), në përputhje me Konventën e Stambollit (KS).

Rezultati: Të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore (GBV) do të përfitojnë nga shërbime më të mirëfinancuara dhe me cilësi të përmirësuar.

Grupi i Synuar/ Përfituesit:

- Gratë e mbijetuara nga dhuna me bazë gjinore (DhBGj)
- Fëmijët që janë dëshmitarë ose përjetojnë dhunë
- Vendimmarrësit vendorë dhe qendrorë
- Institucionet përgjegjëse për mbështetjen ndaj DhBGj dhe
- Strukturat e qeverisjes vendore (bashkitë)
- Organizatat e Shoqërisë Civile të Grave (OSHC) dhe Media

Vendi / Rajoni: Vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia

Partnerët

- **Shqipëri:** Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
- **Kosovo:** Rrjeti i Grave të Kosovës
- **Serbia:** Qendra Autonome e Grave
- **Bosnja dhe Hercegovina:** Fondacioni Gratë e Bashkuara
- **Maqedonia e Veriut:** Rrjeti Kombëtar për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
- **Mali i Zi:** Qendra për të Drejtat e Grave

Sesioni 1: Kuadri Ndërkombëtar dhe Politikat Kombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Dhunës



Znj. Elona Fana
Menaxhere e Programeve
ADA Shqipëri

Znj. Elona Fana moderoi panelin e parë të konferencës, i cili trajtoi "Kuadrin Ndërkombëtar dhe Politikat Kombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Dhunës." Ky panel u fokusua në shqyrtimin e bashkëveprimit midis kuadrove ndërkombëtare, siç është Konventa e Stambollit, dhe politikave kombëtare që janë krijuar për të mbrojtur dhe fuqizuar viktimat e dhunës.

Gjatë diskutimit, u theksua progresi i arritur deri tani, duke përfshirë përmirësimet në legjislacion dhe implementimin e masave të reja, por gjithashtu u theksuan mangësitë dhe sfidat që ende ekzistojnë në ofrimin e shërbimeve.

Një nga temat kryesore ishin shërbimet e specializuara dhe integrimi i nevojave të viktimave të dhunës në një qasje të gjithanshme, duke përfshirë mbështetje psikologjike, ligjore dhe ekonomike. U diskutua për rëndësinë e një mbështetjeje më të fuqishme për grupet më të marginalizuara, si gratë me probleme mendore dhe ato që jetojnë në zona rurale.

Znj. Fana theksoi se, përveç avancimeve pozitive, ka ende një nevojë urgjente për alokimin e fondeve më të zgjeruara dhe të dedikuara për të siguruar shërbime të qëndrueshme dhe për të trajnuar profesionistët që ata të mund të përballojnë sfidat me të cilat këto viktimat përballen.

Një tjetër çështje e diskutuar ishte përpjekja për të siguruar një mbështetje të qëndrueshme për viktimat pas daljes nga strehimet dhe se si mund të mundësohet riintegrimi i tyre në shoqëri. U theksua gjithashtu rëndësia e bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile për të siguruar që shërbimet të ofrohen në mënyrë efektive dhe të përqendruara tek nevojat specifike të viktimave.

Përfundimisht, paneli vuri në dukje se është thelbësore që qeveria shqiptare, në nivelin qendror dhe lokal, të vijojë të ofrojë mbështetje për viktimat e dhunës, veçanërisht përmes aksesit në drejtësi dhe ofrimin të mbështetjes juridike falas.

Diskutimi theksoi se ka ende mundësi për përmirësime dhe se është i nevojshëm një angazhim i vazhdueshëm për të përmirësuar shërbimet ekzistuese dhe për të krijuar modele të reja dhe të qëndrueshme për mbështetje dhe integrim.

Sesioni 1: Kuadri Ndërkombëtar dhe Politikat Kombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Dhunës



Znj. Etleva Sheshi

Drejtoreshë e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, MSHMS

Znj. Etleva Sheshi, gjatë pjesëmarrjes në panelin e konferencës për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare, falënderoi organizatorët dhe theksoi rëndësinë e 16 Ditëve të Aktivizmit, që ofrojnë mundësi për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare për këtë fenomen.

Ajo theksoi se angazhimi për të ofruar mbështetje dhe mbrojtje për viktimat vazhdon gjatë gjithë vitit, duke përfshirë bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe koordinatorët vendorë që janë në vijën e parë të mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat.

Znj. Sheshi theksoi se Shqipëria ka bërë përparime të konsiderueshme në vitet e fundit, duke ndërtuar standarte dhe ngritur institucione të reja për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare. Kjo ka përfshirë forcimin e pushtetit vendor për të ofruar shërbime direkte për viktimat dhe përmirësimin e legjislacionit, përfshirë një ligj të veçantë për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe përmirësime në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Shqipëria ka ratifikuar konventa ndërkombëtare të rëndësishme, përfshirë Konventën e Stambollit, dhe ka përmirësuar masat për kufizimin e dhunës dhe zgjerimin e definimit të rrethit familjar. Vendimi i Shqipërisë për të qenë pjesë e Konferencës së Pekinit dhe për të krijuar plane kombëtare veprimi ka ndihmuar në parandalimin dhe mbështetje për gratë, duke përfshirë trajtimin e dhunës si pjesë të legjislacionit të përditësuar.

Përkundër progresit, ka ende sfida, veçanërisht në nivelin vendor, ku ndodhin shumica e rasteve të dhunës dhe ku viktimat kërkojnë mbështetje. Ajo theksoi nevojën për një përgjegjshmëri të lartë dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve për viktimat, duke u siguruar që shërbimet janë profesionale dhe të koordinuara. Megjithatë, ka ende nevojë për përmirësime të mëtejshme për të siguruar që çdo aktor të luajë rolin e tij me përgjegjësi të plotë në mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës.

Një tjetër sfidë që u theksua ishte fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimeve dhe ofrimi i mundësive për ata që janë të angazhuar në trajtimin e viktimave të dhunës. Puna e koordinuar mes aktorëve të ndryshëm, përfshirë institucionet qendrore, koordinatorët vendorë dhe shoqërinë civile, është e domosdoshme për të siguruar një përgjigje të shpejtë dhe efektive.

Znj. Sheshi nënvizoi gjithashtu përpjekjet për një ligj të ri për barazinë gjinore, i cili do të integrojë në mënyrë të plotë mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore. Pjesë e këtij ligji do të jetë fuqizimi i mekanizmave koordinues, si Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore, për të menaxhuar masat kundër dhunës dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave. Ky është një hap i rëndësishëm në krijimin e një kornize të fortë ligjore dhe institucionale për të luftuar dhunën në shoqëri. Në mbyllje, ajo theksoi rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe shkëmbimit të përvojave pozitive, duke nxjerrë në pah shembuj të suksesshëm të bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe institucioneve të ndryshme, si bashkëpunimi midis bashkive Tiranë dhe Kamëz, që ndihmon në shkëmbimin e eksperiencës për trajtimin e rasteve të dhunës.

Sesioni 1: Kuadri Ndërkombëtar dhe Politikat Kombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Dhunës



Znj. Rosa Logar (online)

Ish-Presidentja e GREVIO, eksperte dhe aktiviste për mbrojtjen kundër dhunës ndaj grave

Znj. Rosa Logar, ish-Presidentja e GREVIO-s, eksperte dhe aktiviste për mbrojtjen kundër dhunës ndaj grave, mori pjesë online në konferencë. Në prezantimin e saj, ajo theksoi rëndësinë e standardeve dhe shërbimeve për mbështetje ndaj të mbijetuarve të dhunës, duke u bazuar në Konventën e Stambollit.

Znj. Logar e trajtoi problemin e vazhdueshëm të dhunës ndaj grave, duke theksuar se, megjithë përpjekjet, ajo mbetet një çështje thellësisht e rrënjosur në shumë shtete. Ajo përmendi vlerësimet e fundit nga GREVIO për Austrinë dhe Shqipërinë, që treguan se dhuna vazhdon të prekë një numër të konsiderueshëm grash në mbarë botën.

Sipas raporteve të fundit, një e treta deri në një e pesta e grave janë ende të prekura nga dhuna, çka tregon se dhuna ndaj grave dhe vajzave është një problem shumë i thellë. Logar shpjegoi se elementi kryesor i Konventës së Stambollit është siguria e mbështetjes për gratë viktime të dhunës dhe familjet e tyre. Ajo theksoi rëndësinë e shërbimeve të integruara që punojnë së bashku për të ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse. Shqipëria ka bërë përparime të mëdha në këtë fushë, veçanërisht në zhvillimin e qasjes të integruar, që përfshin koordinatorët vendorë.

Konventa e Stambollit thekson gjithashtu nevojën për shërbime të specializuara si strehëza për gratë, qendra këshilluese dhe linja telefonike 24-orëshe për viktimat. Logar përmendi edhe rëndësinë e sigurisë dhe mundësive për gratë me aftësi të kufizuara dhe për fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës, duke theksuar se ata gjithashtu duhet të mbështeten. Megjithatë, ajo e pranoi se ende ka shumë punë për t'u bërë, pasi asnjë shtet nuk ka arritur të plotësojë rekomandimet për sa i përket krijimit të qendrave për dhunën seksuale dhe strehëzave për çdo 10,000 banorë.

Një tjetër element i rëndësishëm që Logar theksoi ishte kuptimi gjinor i dhunës. Ajo theksoi se dhuna që përjetojnë viktimat nuk është faj i tyre dhe se të drejtat e viktimave duhet të jenë gjithmonë në qendër të çdo veprimi. Ajo gjithashtu përmendi rëndësinë e parimit diskriminues në ofrimin e mbështetjes, duke siguruar që asnjë viktimë të mos përjashtohet nga shërbimet për shkak të kombësisë, grupeve etnike apo faktorëve të tjerë.

Znj. Logar foli gjithashtu për rëndësinë e qasjes mbi bazën e të drejtave të njeriut, duke nënvizuar domosdoshmërinë për të shmangur viktimizimin e dytë, që mund të përkeqësojë traumat e mbijetuarve. Ajo përmendi gjithashtu rrjetin e shërbimeve që Austria ka zhvilluar gjatë 45 viteve të fundit, duke përfshirë linjat e ndihmës kombëtare, strehëzat dhe qendrat e ndërhyrjes. Në vijim ajo përmendi gjithashtu programet e parandalimit të dhunës të bazuara në komunitet që janë zhvilluar në Austri, ku ndërjegjësimi mbi dhunën në familje bëhet në nivel lokal dhe individët lidhen me shërbimet e specializuara. Ajo vlerësoi progresin e bërë nga Shqipëria në këtë fushë dhe inkurajoi avancimin e mëtejshëm.

Në përfundim, ajo theksoi se të gjithë mund të preken nga dhuna, dhe mbështetja për viktimat është një përgjegjësi kolektive.

Sesioni 1: Kuadri Ndërkombëtar dhe Politikat Kombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Dhunës



Z. Ergys Qirici

Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas,
Ministria e Drejtësisë

Zoti Qirici theksoi rëndësinë e aksesit në drejtësi dhe ndihmës juridike falas, një element kyç për ata që janë në nevojë, veçanërisht për individët dhe grupet më të marginalizuara. Ai ndau përparimet e bëra në krijimin e institucioneve përkatëse që ofrojnë mbështetje ligjore për shtresat e cënueshme të shoqërisë, si dhe rëndësinë e reformës në drejtësi, e cila ka sjellë ndryshime thelbësore në këtë fushë. Ministria e Drejtësisë, së bashku me aktorët lokalë dhe ndërkombëtarë, ka zhvilluar një sistem të organizuar dhe të strukturuar për ofrimin e ndihmës juridike falas, duke krijuar një legjislacion të ri për këtë shërbim. Në vitin 2017, u miratua ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (Ligji nr. 111), i cili hyri në fuqi në qershor të vitit 2018 dhe solli risitë e tij krahasuar me ligjin e mëparshëm të vitit 2008.

Ligji i ri përfshiu një strukturë më të organizuar, ku ndihmën juridike e ofron jo vetëm Ministria e Drejtësisë, por edhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomat Kombëtare të Avokatisë, si dhe gjykatat që ofrojnë përfaqësim juridik për ata që nuk kanë mundësi financiare për të paguar avokatët. Një nga risitë e ligjit të ri ishte përfshirja e viktimave të dhunës në familje, viktimave të abuzimit seksual dhe të trafikuarve të qenieve njerëzore në çdo fazë të procedurës penale. Ky ligj ofron ndihmën juridike falas për këto grupe në çdo hap të procesit ligjor, që nga këshillimi dhe orientimi, deri te përfaqësimi në gjykata dhe përgatitja e akteve ligjore.

Aktualisht, janë 46 ofrues të ndihmës juridike parësore, duke përfshirë organizatat që janë autorizuar nga Ministria e Drejtësisë. Këto qendra ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe ata që janë pa të ardhura dhe pa pasuri. Një element i rëndësishëm është që ndihma juridike ofrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në 20 qendra të hapura që nga viti 2020, të cilat mbulojnë të gjitha qarqet e Shqipërisë, duke përfshirë edhe qytetet më të mëdha.

Në vitin 2023, Ministria e Drejtësisë ka mbështetur ndihmën juridike për viktimat e dhunës dhe viktimat e trafikimit duke rritur buxhetin për mbulimin e shpenzimeve për avokatët dhe ekspertët që ofrojnë shërbime juridike. Ndhma juridike përfshin këshillim, orientim dhe ndihmë për përgatitjen e kërkesave ligjore si dhe përfaqësim në gjykata për individë që nuk kanë mundësi financiare për të paguar avokatët. Gjatë vitit 2023, për ndihmën juridike është përdorur një shumë prej mbi 100 milion lekësh nga buxheti i shtetit.

Një tjetër element i rëndësishëm është përfshirja e shërbimeve të ndihmës juridike online, ku qytetarët mund të marrin shërbim juridik falas përmes një linje telefonike të disponueshme 24 orë në ditë. Ky shërbim është ofruar për të ulur kostot dhe për t'iu mundësuar qytetarëve të kenë akses në drejtësi pa pasur nevojë të udhëtojnë apo të kenë kostot e tjera të lidhura me shërbimet ligjore.

Për të përmirësuar më tej ofrimin e shërbimeve juridike, Ministria e Drejtësisë ka përfshirë në strategjitë e saj trajnime dhe fushata ndërgjegjësimi për ofruesit e ndihmës juridike, duke përfshirë jo vetëm staf të qendrave të ndihmës juridike, por edhe organizata jo-fitimprurëse dhe universitete, duke organizuar aktivitete promovuese dhe edukative për qytetarët.

Një zhvillim i fundit është rritja e financimit për qendrat e ndihmës juridike falas me 14% për vitin 2024, që do të mundësojë përfshirjen e qendrave të tjera dhe shërbime më të mira për qytetarët. Ndhma juridike për viktimat e dhunës është bërë më e arritshme me përjashtimin nga tarifat gjyqësore, duke rritur aksesin në drejtësi për ta.

Zoti Qirici theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore, agjencie ndërkombëtare dhe pushtetit lokal për mbrojtjen e viktimave dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi, duke u fokusuar gjithashtu në uljen e ngarkesës në gjykata dhe ofrimin e shërbimeve më efikase për ata që kërkojnë ndihmë juridike.

Sesioni 1: Kuadri Ndërkombëtar dhe Politikat Kombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Dhunës



Znj. Vilma Shurdha
Komisionere,
Institucioni i Avokatit të Popullit

Vilma Shurdha, komisionere pranë Avokatit të Popullit, ka theksuar rëndësinë e përpjekjeve të përbashkëta për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, duke nënvizuar se dhuna ndaj grave mbetet një problem i thellë dhe aktual në shoqërinë shqiptare. Ajo theksoi se forume të tilla janë mundësi për të analizuar arritjet dhe sfidat, si dhe për të riafirmuar angazhimin e institucioneve dhe shoqërisë civile në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Sipas znj. Shurdha, pavarësisht përparimeve, implementimi i strategjive për mbrojtjen e viktimave të dhunës është ende i mangët, duke çuar në shërbime të kufizuara dhe me cilësi të ulët.

Në këtë kontekst, znj. Shurdha e vuri theksin te rëndësia e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, duke theksuar se përpjekjet për t'i ofruar këto shërbime janë ende të pamjaftueshme. Ajo përmendi raportet e Avokatit të Popullit dhe rekomandimet që drejtohen tek institucionet për përmirësimin e shërbimeve dhe krijimin e mundësive për riintegrimin e viktimave në jetën e përditshme. Sipas Shurdhës, përmirësimet ligjore dhe strategjitë ekzistuese për barazinë gjinore dhe mbrojtjen e viktimave kanë ende mangësi të dukshme në implementimin e tyre dhe këto mangësi çojnë në mungesë shërbimesh dhe cilësi të ulët të shërbimeve për viktimat, veçanërisht në zonat rurale dhe më të largëta. Ajo nënvizoi gjithashtu mungesën e shërbimeve të dedikuara për gratë me probleme të shëndetit mendor, një grup i prekshëm që përballet me vështirësi të shumta.

Znj. Shurdha gjithashtu diskutoi sfidat e identifikimit të viktimave dhe vërejtjen e një shtimi të kërkesave për mbështetje ekonomike dhe strehim për gratë viktime të dhunës. Ajo tha se ligji për strehimin social përfshin gratë e dhunuara si kategori prioritare, por, megjithatë, ka një disproporcion mes kërkesave dhe mundësive për t'i plotësuar ato, veçanërisht në lidhje me ofrimin e bonuseve të qirasë dhe banesave sociale.

Një tjetër çështje e përmendur ishte nevoja për të pasur një përgjigje të koordinuar dhe të integruar nga të gjitha institucionet për të siguruar mbrojtjen e viktimave të dhunës dhe për t'i mundësuar atyre që të arrijnë potencialin e tyre maksimal. Ajo theksoi se ndihma për viktimat duhet të jetë më e koordinuar dhe më e qëndrueshme dhe se legjislacioni aktual ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

Përfundimisht, znj. Shurdha theksoi se është e nevojshme të sigurohet një përgjigje më e strukturuar dhe e koordinuar përballë dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe që kjo të ndihmojë në parandalimin e kësaj dhune dhe fuqizimin e të drejtave të viktimave. Ajo nënvizoi gjithashtu rëndësinë e krijimit të një mekanizmi të monitorimit për femicidin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna, të cilat do të ndihmojnë në identifikimin dhe ndalimin e këtij fenomeni.

Sesioni 2: Qasje Multi-Sektoriale për Rehabilitimin dhe Riintegrimin Cilësor



Znj. Ines Leskaj
Drejtoreshë Ekzekutive
AWEN

Sesioni i dytë u moderuar nga Drejtoresha Ekzekutive e AWEN, Znj. Ines Leskaj, e cila theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të të gjitha strukturave dhe aktorëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Znj. Leskaj vuri në dukje se, ndërsa ka pasur përparime në ofrimin e shërbimeve direkte si mbështetje psikologjike dhe ligjore, faza e rehabilitimit dhe riintegrimin afatgjatë është ende një sfidë e madhe.

Znj. Leskaj e vuri theksin tek mungesa e një zinxhiri të fortë për integrimin e viktimave në shoqëri, duke përfshirë bashkëpunimin nga MSHMS, institucionet lokale dhe shërbimet e strehimit. Ajo gjithashtu vuri në dukje se shumë bashki kanë mbështetur shërbimet për viktimat e dhunës, por ato janë ende të kufizuara, sidomos në aspekte të tilla si strehimi afatgjatë dhe mbështetje të qëndrueshme. Leskaj po ashtu theksoi se, pavarësisht angazhimit të shtetit dhe institucioneve, mbështetja financiare për këto shërbime ka qenë e pamjaftueshme dhe ka munguar një mbështetje buxhetore e qëndrueshme për t'i siguruar këto shërbime në mënyrë të vazhdueshme.

Një nga sfidat kryesore që znj. Leskaj theksoi ishte mungesa e mbështetjes financiare të qëndrueshme për shërbimet për viktimat. Ajo u shpreh se shumë donatorë janë tërhequr dhe se ka pasur një vështirësi në sigurimin e fondeve për shërbime të tilla, duke përmendur gjithashtu rëndësinë e qeverisë shqiptare që të marrë më shumë përgjegjësi për financimin e këtyre shërbimeve dhe të sigurojë që ato të jenë të qëndrueshme dhe me mbështetje afatgjatë.

Modeli i suksesit i bashkisë Tiranë, si dhe raste të tjera të bashkive që ofrojnë shërbime direkte për viktimat e dhunës, janë shembuj të suksesshëm që mund të ndahen dhe të përdoren si modele për bashki të tjera në Shqipëri. Znj. Leskaj theksoi se konferenca të tilla janë një mundësi e shkëlqyer për të ndarë këto praktika dhe për të ndërmarrë hapa konkrete në drejtim të ofrimit të shërbimeve më të mira dhe të qëndrueshme për viktimat e dhunës.

Bashkëpunimi dhe angazhimi i të gjithë aktorëve të shoqërisë civile dhe institucioneve është kyç për të siguruar mbështetje dhe rehabilitim dhe shërbime cilësore për viktimat e dhunës me bazë gjinore.



Motër Alma Zogu

“Rozalba”, streha për fëmijë viktime të abuzimit në Gjadër, Lezhë

Motër Alma theksoi rëndësinë e fazës së integritit për vajzat viktime të dhunës në familje dhe abuzimit, duke nënvizuar vështirësitë që përballojnë ato gjatë kësaj periudhe.

Streha ofron mbështetje për vajzat deri në moshën 18 vjeçare, ndërkohë që faza e integritit kërkon shumë delikatesë, pasi ka mundësi që vajzat të kthehen në ambientet e dhunës ose të bëhen të ndjeshme ndaj fenomeneve që kanë jetuar më parë. Ajo shpjegoi se një pjesë e vajzave që dalin nga streha mund të përfitojnë kurse profesionale, ndërsa të tjerë ndjekin universitete dhe mund të punësohen me mbështetje të qendrës.

Motër Alma theksoi se faza e integritit është e vështirë, edhe pse përpjekjet për rehabilitimin dhe integrimin e vajzave janë të rëndësishme. Kjo fazë kërkon mbështetje të vazhdueshme për vajzat, veçanërisht pasi ato dalin nga qendrat dhe përballen me një shoqëri që shpesh nuk është e gatshme t'i pranojë plotësisht. Pavarësisht përpjekjeve të qendrës për t'u mundësuar atyre mundësi për punësim dhe mundësi studimi, integrimi mbetet një proces i vështirë dhe shpeshherë vajzat nuk gjejnë mbështetje të mjaftueshme pas daljes nga streha.

Një tjetër pikë që u diskutua ishte mungesa e politikave që mbështesin riintegrimin e këtyre vajzave në shoqëri. Ajo theksoi se, ndonëse ka shërbime të ndryshme që ofrohen gjatë qëndrimit të vajzave në strehë, ajo që mungon është një plan konkret dhe strategji që mund të ofrojë mbështetje për vajzat pas moshës 18 vjeçare. Në shumë raste, ato përballen me vështirësi të mëdha dhe ndihen të pambrojtura me shërbime që mund të ofrohen në nivel kombëtar. Ajo gjithashtu nënvizoi se duhet të krijohet një rrjet i fortë që përfshin shërbimet sociale, juridike dhe psikologjike falas, si edhe ndihmën e ofruar nga institucionet shtetërore, për të siguruar një integrim të suksesshëm për viktimat e dhunës. Qendrat dhe organizatat joqeveritare duhet të punojnë së bashku për të ofruar mbështetje të qëndrueshme, ndërkohë që institucionet e shtetit duhet të marrin më shumë përgjegjësi dhe të sigurojnë që këto vajza të mos mbeten të braktisura pas daljes nga qendrat.

Motër Alma theksoi se, edhe pse qendrat kanë ofruar mbështetje dhe mundësi për vajzat, ka ende shumë punë për të bërë për të siguruar që ato të jenë të mbrojtura dhe të integrohen në mënyrë të suksesshme në shoqëri. Ajo theksoi se integrimi kërkon më shumë se vetëm mbështetje për qeratë. Duhet të ndërtojmë projekte dhe plane që ndihmojnë vajzat të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ky është një proces që kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm dhe angazhim nga të gjithë aktorët e shoqërisë për të siguruar një të ardhme më të mirë për këto vajza.

Në përfundim, motër Alma theksoi se duhet të investohet më shumë në këtë fushë, duke krijuar një zinxhir mbështetjeje nga ministritë dhe bashkitë, për të siguruar mbrojtjen dhe integrimin e plotë të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Ajo bëri thirrje për krijimin e një sistemi më të koordinuar dhe më të fuqishëm që do t'i mundësojë këtyre vajzave të largohen nga cikli i dhunës dhe të zhvillojnë një jetë të pavarur dhe të suksesshme.

Sesioni 2: Qasje Multi-Sektoriale për Rehabilitimin dhe Riintegrimin Cilësor



Znj. Anisa Subashi

Drejtore e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë


Në vitin 2024, Bashkia Tiranë ka menaxhuar një numër alarmant të rasteve të dhunës në familje, duke shënuar 639 denoncime në polici dhe 720 raste të tjera të menaxhuara që lidhen me dhunën në familje gjatë viteve të kaluara. Shërbimi për viktimat e dhunës në familje dhe integrimi i tyre është një prioritet i politikave dhe programeve të Bashkisë, duke përfshirë planet sociale që janë në zhvillim. Pjesë e këtij angazhimi janë planet për barazi gjinore, ku Bashkia Tiranë është duke punuar në raundin e tretë për planin e veprimit vendor për barazinë gjinore, i cili do të zgjerohet deri në vitin 2027. Po ashtu, plani për integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe i personave me aftësi të kufizuara është gjithashtu pjesë e këtij procesi të gjerë.

Mekanizmi i referimit për dhunën, i cili përfshin 16 institucione, përfshin organizata joqeveritare dhe është në proces zgjerimi për të përfshirë edhe aktorë si media dhe shëndetësia. Ky mekanizëm është konsoliduar në vitet e fundit dhe Bashkia ka ngritur strukturën e njësive për mbrojtjen e fëmijëve, duke siguruar specialistë në çdo njësi administrative të Tiranës. Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve janë të pranishme në 27 njësite e Tiranës dhe në secilën njësi ka punonjës socialë dhe psikologë që punojnë me një fokus të veçantë në dhunën në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Një nga sfidat më të mëdha ka qenë ofrimi i shërbimeve sociale në zonat rurale. Për këtë, Bashkia ka planifikuar hapjen e dy qendrave të reja në Zall Herr dhe Vaqarr, që synojnë të mbulojnë nevojat në këto zona të largëta. Zgjerimi i shërbimeve ka përfshirë gjithashtu dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmes trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit të shërbimeve sociale dhe psiko-sociale. Aktualisht, në shtatë qendrat komunitare të Bashkisë Tiranë, rreth 900 gra dhe vajza përfitojnë shërbime, si dhe përmes partneriteteve me organizatat jo fitimprurëse janë diversifikuar shërbimet.

Për vitin 2025, Bashkia ka parashikuar një buxhet të rritur për të mbështetur viktimat e dhunës dhe koordinatorët vendorë, si dhe një program të ri që synon punësimin e 10 grave viktime të dhunës. Një tjetër nismë mbështetëse është projekti për fuqizimin e vajzave dhe grave, ku janë përfshirë rreth 90 gra me biznese të reja dhe ekzistuese. Ky program ka arritur rritje dhe numri i grave përfitueses pritet të arrijë në 30 gra çdo vit, duke mbështetur ato që janë kryefamiljare, të mbijetuara të dhunës në familje dhe të trafikimit.

Në këtë kuadër, Bashkia Tiranë po ndërmerret gjithashtu nisma për mbështetje të vajzave dhe grave që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike, duke ofruar ndihma për kujdesin personal gjatë ciklit menstrual dhe mbështetje për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, ku regjistrimi është falas për këtë kategori. Këto nisma janë reflektuar në buxhetin për vitin 2025-2027 dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e integritetit dhe mbrojtjes së grave dhe vajzave në shoqëri. Bashkia Tiranë ka angazhimin e saj të fortë për të ofruar mbështetje dhe integrim të plotë për viktimat e dhunës në familje, duke siguruar shërbime cilësore dhe mbështetje të vazhdueshme për ta.



Dëshmi nga një e mbijetuar: Përjetime të drejtpërdrejta mbi pengesat në rehabilitim dhe riintegrim si dhe ndikimin pozitiv të shërbimeve në bashkëpunim.

Historia e Elda*: Elda është një grua e fortë, që jeton në Durrës me dy vajza. Ajo ka kaluar shumë vështirësi në jetën e saj, dhe tani që është në proces divorci, e ndan me ne historinë e saj të vështirë, por të mbushur me forcë dhe vendosmëri. "Nuk është e lehtë të flasësh për të shkuarën, sepse papritur të kthehen kujtime të dhimbshme," thotë Elda, duke kujtuar periudhën e ndarjes dhe vështirësitë që ka kaluar.

**Emri ka ndryshuar për efekt ruajtje anonimiteti*

Ajo ka qenë e ndarë për më shumë se tre vjet dhe ka mundur të mbijetojë vetëm, duke punuar shumë për të siguruar jetesën dhe për të paguar qiranë. "Kam punuar më shumë se **13 orë në ditë**," shpjegon Elda, "dhe kam pasur momente kur jam detyruar të largohem nga puna për shkak të **ngacmimeve seksuale** që kam përjetuar në vendin e punës." Kjo është një pjesë e realitetit të saj, që nuk është e lehtë për t'u shprehur, por që duhet thënë për të kuptuar më mirë përjetimet e saj.

Elda ka qenë e vendosur të mos e ndalë rrugëtimin e saj, sepse e di që ka shumë gra dhe vajza që nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë. "Kam arritur të jetoj e vetme, të siguroj ushqimin për fëmijët e mi dhe të bëj gjithçka që ato të kenë një jetë më të mirë," thotë ajo. Një nga sfidat më të mëdha për të ka qenë siguria financiare dhe sigurimi i ushqimit për vajzat e saj. Shërbimin juridik dhe mbështetjen psikologjike e ka përfituar falas, një mbështetje që i ka dhënë mundësinë të përballojë sfidat e jetës dhe të vazhdojë të luftojë për të ardhmen e saj dhe vajzave të saj.

Megjithatë, Elda ka pasur gjithmonë një ëndërr: Të studiojë dhe t'i mundësojë vajzave të saj një edukim të mirë. Pavarësisht se nuk ka pasur mundësinë të ndjekë shkollën për vete, ajo ka bërë gjithçka që vajzat e saj të kenë mundësi për një arsimim të plotë dhe të formohen si individë të suksesshëm. "Të edukosh fëmijët është gjithçka. Kam bërë të pamundurën për vajzat e mia që ato të kenë një mundësi më të mirë se sa e kam pasur unë," thotë Elda, duke ndarë emocione të thella për sfidat e saj dhe dëshirën e saj për t'i dhënë vajzave gjithçka që mundet.

Edhe pse jeta e saj është mbushur me vështirësi, ajo e di që çdo hap që ka bërë deri tani ka qenë një hap përpara drejt një jete më të mirë për të dhe vajzat e saj. "Unë jam një grua e fortë," thotë Elda me krenari. "Dhe, ndonëse kam kaluar shumë peripeci, do të vazhdoj të luftoj për të arritur ëndrrat e mia dhe për të siguruar një të ardhme të ndritur për vajzat e mia."

Sesioni 2: Qasje Multi-Sektoriale për Rehabilitimin dhe Riintegrimin Cilësor



Znj. Brikena Puka
Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra Vatra, Vlorë

Znj. Puka, përfaqësuese e organizatës Vatra, nisi fjalën e saj duke falënderuar organizatorët për mundësinë që të ishte pjesë e panelit dhe për bashkëpunimin e ngushtë që organizata Vatra ka me shumë organizata të tjera që punojnë me përkushtim për mbrojtjen e të drejtave të grave, veçanërisht atyre që janë viktimat e dhunës me bazë gjinore. Ajo theksoi rëndësinë e punës së Vatrës, e cila është e fokusuar në akomodimin, rehabilitimin, dhe reintegrimin e viktimave të trafikimit, dhunës me bazë gjinore dhe abuzimit seksual. Gjithashtu, organizata ofron mbështetje ligjore dhe psikologjike, si dhe ndihmë në çështje të drejtësisë, duke ofruar asistencë në gjykatë dhe ndihmë për përfaqësimin e viktimave.

Znj. Puka theksoi gjithashtu fuqizimin ekonomik të viktimave përmes formimit profesional dhe mundësisë që ato të krijojnë mikrobiznese me mbështetje financiare nga organizata. Ajo foli për sfidat që organizata dhe viktimat e dhunës përballen çdo ditë, duke përmendur edhe vështirësitë financiare dhe nevojën për burime më të mëdha për të mbështetur këto shërbime. Sipas saj, për të ofruar shërbime cilësore dhe afatgjata, organizata ka nevojë për një buxhet të madh, i cili për Vatrën është 60 milionë lekë (600,000 euro) në vit. Ajo theksoi se vetëm 30% e këtij buxheti mbulohet nga shteti, ndërsa pjesa tjetër financohet nga donatorë.

Ndër të tjera, u theksua gjithashtu se një prej sfidave më të mëdha për organizatën mbetet strehimi afatgjatë i viktimave të dhunës. Ajo përmendi se në Vlorë, për shembull, kanë pasur vështirësi të paguajnë qeratat e apartamenteve dhe të sigurojnë shërbime për fëmijët e viktimave. Vështirësitë e tjera janë të shumta, veçanërisht për ata që kërkojnë ndihmë për pagesat e qerave, për ilaçe dhe për nevoja të tjera themelore.

Përsa i përket politikave të mbështetjes për viktimat, ajo ngriti shqetësimin që shumë gra janë të varura nga ndihma që ofrojnë organizatat, ndërkohë që ato dëshirojnë të punojnë dhe të sigurojnë të ardhurat e tyre. Znj. Puka gjithashtu theksoi se për të realizuar shërbimet e nevojshme dhe për të pasur një qëndrueshmëri financiare, organizatat si Vatra duhet të sigurojnë fonde nga donatorë të ndryshëm. Ajo nënvizoi se për këtë arsye është e rëndësishme të ketë një koordinim të ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë shtetin dhe bashkitë, për ti mbështetur këto viktimat dhe për të siguruar shërbime afatgjata për to.

Në fund, znj. Puka foli për procesin e hartimit të planit social të Bashkisë Vlorë, i cili u miratua së fundmi dhe shprehu shpresën që ky plan të zbatohet me sukses, duke i dhënë prioritet viktimave të dhunës dhe trafikimit. Ajo u shpreh se kjo është një mundësi për të ndihmuar viktimat dhe për të ofruar mbështetje, si dhe kërkoi që ky model të shpërndahej dhe në bashki të tjera si një shembull pozitiv.

Sesioni 2: Qasje Multi-Sektoriale për Rehabilitimin dhe Riintegrimin Cilësor



Znj. Sonila Reçi
Qendra Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje

Në fjalën e saj, Znj. Sonila Reçi, Drejtoreshë e Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje, theksoi rëndësinë që ka konferenca për mundësinë për të prezantuar shërbimet që ofron qendra që ajo drejton. Ajo përmendi se, për shkak të natyrës konfidenciale të shërbimeve, nuk mund të publikonte shifra, por ishte e rëndësishme të bëhej një prezantim i shërbimeve të ofruara nga qendra. Qendra Kombëtare, e vendosur në Kamëz, ofron shërbim rezidencial 24/7 për viktimat e dhunës në familje, që nga momenti kur ato përfundojnë procedurat në komisarjat dhe paraqiten përmes mekanizmit të referimit.

Qendra ofron një paketë të plotë shërbimesh, duke përfshirë mbështetje psikosociale, financiare, strehim, veshmbathje dhe ndihmë ligjore falas. Ajo vuri theksin te marrëveshja e firmosur me Ministrinë e Drejtësisë, e cila është një mbështetje e jashtëzakonshme, duke mundësuar aksesin e viktimave të dhunës në shërbime ligjore falas, një mundësi që nuk ka ekzistuar më parë për to. Po ashtu, Znj. Reçi përmendi rëndësinë e bashkëpunimit të Qendrës me Zyrat e Punës në Kamëz dhe Tiranë, që kanë ofruar mundësi punësimi për viktimat e dhunës, duke i ndihmuar ato të integrohen dhe të përballojnë sfidat e jetës. Puna e ofruar ka qenë e fokusuar në pozicione të thjeshta që përputhen me aftësitë e viktimave dhe përgatitjen e tyre profesionale, duke iu dhënë mundësi që të përgatiten për një jetë të pavarur.

Znj. Reçi theksoi gjithashtu se një sfidë e madhe mbetet riintegrimi i viktimave pas daljes nga qendra. Ndërsa në Bashkinë e Tiranës, gratë kanë mundësi të mbështeten me bonusin e qerasë dhe përfitime të tjera, kjo mundësi nuk është e disponueshme në shumë bashki të tjera. Ajo theksoi nevojën për rritjen e bashkëpunimit dhe ngritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, për të siguruar që viktimat të mos kthehen te dhunuesit pas përfundimit të trajtimit. Sipas saj, ka pasur raste ku, pas një viti trajtimi dhe integrimi, viktimat janë kthyer në ambjentet e dhunës për shkak të mungesës së mbështetjes dhe monitorimit afatgjatë.

Znj. Reçi gjithashtu foli për nevojën e përmirësimit të politikave dhe strategjive të brendshme, si dhe për rritjen e bashkëpunimit me aktorët e tjerë për të siguruar që shërbimet të ofrohen në mënyrë më efikase. Ajo theksoi se në shumë raste, pas daljes nga qendra, viktimat nuk kanë mundësi të vijnë trajtimin dhe integrimin e nevojshëm, duke i lënë ato të pambrojtura dhe të ekspozuara ndaj dhunës. Kjo është një sfidë që kërkon një përgjigje të bashkërenduar dhe përpjekje të vazhdueshme nga të gjithë aktorët e shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore. Në përfundim Znj. Reçi bëri një thirrje për rishikimin e strategjive dhe politikave për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të dhunës në familje, për të siguruar që ato të mos rikthehen në ciklin e dhunës dhe për t'u mundësuar një jetë të re dhe të pavarur.

- **Nevoja për shërbime cilësore dhe të integruara:** Dhuna me bazë gjinore mbetet një problem serioz në Shqipëri, duke i ekspozuar viktimat ndaj barrierave sociale, ekonomike dhe ligjore që vështirësojnë rikuperimin dhe riintegrimin e tyre. Për t'u përballur me këto sfida, është thelbësore ofrimi i shërbimeve të specializuara, përfshirë mbështetje psikologjike, ligjore dhe ekonomike, në një qasje të integruar që garanton trajtim të gjithanshëm dhe të qëndrueshëm.
- **Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave kombëtare:** Shqipëria ka shënuar përparime të dukshme me ratifikimin e Konventës së Stambollit dhe përforcimin e kuadrit ligjor, duke krijuar bazat për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave. Megjithatë, sfida të rëndësishme mbeten në zbatimin e plotë të masave dhe monitorimin e efektivitetit të tyre. Integrimi i buxhetimit gjinor në politikat publike mund të ndihmojë në alokimin më të drejtë dhe të efektshëm të burimeve.
- **Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm:** Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe aktorëve ndërkombëtarë është thelbësor për ofrimin e mbështetjes së qëndrueshme për viktimat. Një qasje e integruar kërkon angazhim për të harmonizuar veprimet dhe për të siguruar që shërbimet janë të përqendruara në nevojat konkrete të viktimave dhe mbështeten nga burime të qëndrueshme buxhetore.
- **Mbështetje e mjaftueshme dhe e qëndrueshme për viktimat:** PMbështetja për viktimat duhet të jetë e vazhdueshme dhe e financuar në mënyrë të qëndrueshme nga shteti. Aktualisht, ekzistojnë mangësi të thella dhe të paqarta në mbështetjen buxhetore dhe për këtë arsye integrimi i buxhetimit gjinor është thelbësor për sigurimin e fondeve të mjaftueshme dhe të qëndrueshme që garantojnë ofrimin e shërbimeve afatgjata. Për të siguruar një mbështetje efektive, qendrat për viktimat duhet të planifikohen në mënyrë strategjike, duke synuar hapjen e një qendre për çdo 100,000 banorë. Këto qendra duhet të ofrojnë shërbime të specializuara rehabilitimi dhe riintegrimi në shoqëri për viktimat dhe fëmijët e prekur nga dhuna në bashkëpunim të ngushtë me institucione të ndryshme publike e private.
- **Sfida e rintegrit:** Pavarësisht përmirësimeve në ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit, riintegrimi mbetet një sfidë madhore, sidomos për viktimat nga zonat rurale dhe ato që përballen me kushte të pafavorshme sociale dhe ekonomike. Programet e mbështetjes duhet të shoqërohen me mekanizma që përfshijnë edhe përmirësimin e mundësive ekonomike dhe sociale të viktimave.
- **Vëmendja ndaj grupeve:** Viktimat me aftësi të kufizuara, ato që jetojnë në zona të izoluara dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës kërkojnë mbështetje të veçantë. Programet duhet të përqendrohen në krijimin e mekanizmave dhe shërbimeve që adresojnë nevojat specifike të këtyre grupeve.
- **Vizioni për të Ardhmen:** Të gjithë aktorët pjesëmarrës u zotuan të thellojnë bashkëpunimin për krijimin e një rrjeti të mirëfunksionuar shërbimesh të integruara. Kjo përfshin edhe rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe alokimin e fondeve në përputhje me buxhetimin gjinor, duke synuar që shërbimet të jenë efektive dhe të përshtatura sipas nevojave të ndryshme të viktimave.

[Kliko për më shumë](#)



Kontakt

Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”

Adresa: Rruga Abdyl Frashëri, Pall 10/1
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 22 555 14

Mob: +355 68 20 59 301

Web: <https://gadc.org.al/>

Na ndiqni në rrjetet tona sociale:

<https://www.facebook.com/GADCAbania/>

https://www.instagram.com/gadc_albania/

https://x.com/GADC_AI

<https://www.youtube.com/channel/UCUZJnKqwQ0cURSqKPc1NaXQ>

